

Vendim nr. 272, datë 28.07.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari, Kryesuese
Ilir Toska, Anëtar
Genti Ibrahimi, Anëtar

në datën 28.07.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 6 (D) 2026 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: DEAR MUÇA

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 4/2021, datë 26.05.2021 të Bordit Disiplinor pranë Dhomës Kombëtare të Noterisë “Për dhënie mase disiplinore ndaj noterit Dear Muça”; urdhrit nr. 383, datë 17.06.2021 të ministrit të Drejtësisë për heqjen e licencës së ushtrimit të profesionit të noterit Dear Muça; vendimit nr. 2953 (80-2021-2995), datë 26.10.2021 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë; vendimit nr. 296 (86-2024-336), datë 06.03.2024 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë; çdo akt administrativ apo gjyqësor paraprirës ose pasues që ka sjellë ose ka mbajtur në fuqi heqjen e licencës profesionale noteriale të kërkesit, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Konstatimi i shkeljes të të drejtave kushtetuese të kërkesit nga: mosveprimi i Gjykatës së Lartë, e cila ndonëse ka pranuar çështjen për shqyrtim nuk ka dhënë vendim brenda afatit ligjor dhe prekluziv prej 90 ditësh, duke shkaktuar zvarritje të pajustificuar dhe mohim faktik të së drejtës për gjykim. Konstatimi se mosveprimi i Gjykatës së Lartë ka sjellë pasiguri juridike të zgjatur, mohim faktik të së drejtës për gjykimin si dhe brenda një afati të arsyeshëm, pamundësi

për rivendosjen e së drejtës profesionale, vazhdim të efekteve të një mase disiplinore të diskutueshme, si dhe cenim serioz të statusit juridik dhe ekonomik të kërkuesit.

Konstatimi i shkeljes së nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 41 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, nenit 6/1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës, së drejtës për ushtrimin e profesionit dhe së drejtës së pronës, parimit të sigurisë juridike dhe të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, parimit të proporcionalitetit dhe barazisë para ligjit.

Konstatimi se mosveprimi i Gjykatës së Lartë ka prodhuar pasoja të drejtpërdrejta dhe të vazhdueshme, duke mbajtur në fuqi efektet e një mase disiplinore që cenon rëndë të drejtat profesionale dhe pasurore patrimoniale të kërkuesit. Rivendosja e të drejtave kushtetuese të kërkuesit dhe eliminimi i pasojave të shkeljes që rrjedhin nga vendimet e kontestuara në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Pezullimi i efekteve të akteve të kundërshtuara deri në përfundimin e shqyrtimit të çështjes nga Gjykata Kushtetuese, për të shmangur pasoja të pariparueshme ndaj kërkuesit.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 17, 41, 42, 131, shkronja “f” dhe 134 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6, 8 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*) dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të saj; nenet 27, 45 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjo i relatorin e çështjes Genti Ibrahim i, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

1. Kërkuesi në vitin 2006 është licencuar për kryerjen e veprimtarisë si noter në Peshkopi. Ministri i Drejtësisë, bazuar në ankesën e një shtetasi, ka urdhëruar nisjen e hetimit administrativ e më pas inspektimin e përgjithshëm të veprimtarisë noteriale të kërkuesit për periudhën 2015-2020, për verifikimin e zbatimit të ligjit nr. 110/2018, datë 20.12.2018 “Për noterinë” (*ligji nr. 110/2018*) dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore. Pas përfundimit të kontrollit, ministri i Drejtësisë ka urdhëruar nisjen e procedimit disiplinor për kërkuesin dhe dërgimin e raportit të hetimit së bashku me dosjen hetimore Bordit Disiplinor të Dhomës Kombëtare të Noterisë (*Bordi Disiplinor*). Ky i fundit, me vendimin nr. 4/2021, datë 26.05.2021 (*vendimi nr. 4/2021*), ka vendosur pranimin e kërkesës për fillimin e procedimit disiplinor, lënien në fuqi të masës disiplinore të propozuar nga ministri i Drejtësisë, si dhe heqjen përfundimtare të licencës së kërkuesit për ushtrimin e profesionit të noterit, duke përcaktuar edhe nxjerrjen e urdhrit për zbatimin e këtij vendimi, sikundër publikimin dhe regjistrimin e tij në regjistrat e masave disiplinore. Pas këtij vendimi ministri i Drejtësisë ka nxjerrë urdhrin nr. 383, datë 17.06.2021 (*urdhri nr. 383/2021*) për heqjen e licencës së ushtrimit të profesionit të noterit kërkuesit.

2. Në këto kushte kërkuesi ka paraqitur padi në gjykatë, me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 4/2021 të Bordit Disiplinor, shfuqizimin e urdhrit nr. 383/2021 të ministrit të Drejtësisë dhe kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme, si dhe fshirjen e çdo regjistrimi të kryer në regjistrin e noterëve pranë Ministrisë së Drejtësisë në lidhje me këtë vendim.

3. Në përfundim të gjyqimit të çështjes, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 2953 (80-2021-2995), datë 26.10.2021, ka vendosur rrëzimin e padisë si të pabazuar, duke arsyetuar se mbi bazën e të gjitha provave të administruara në gjykim ajo gjykatë formoi bindjen dhe arriti në konkluzionin se aktet administrative të kundërshtuara nga kërkuesi janë nxjerrë në përputhje me ligjin e mbi bazën e konstatimeve të sakta se nga ana e tij janë kryer shkelje të rënda disiplinore që kërkojnë marrjen e masës më të rëndë disiplinore. Sipas asaj gjykate, provohen të gjitha shkeljet disiplinore që janë konstatuar gjatë procedimit disiplinor. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuesi.

4. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 296 (86-2024-336), datë 06.03.2024, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë si të drejtë

dhe në përputhje të plotë me provat e marra në gjykim, për sa kohë që gjatë gjykimit është provuar ekzistenca e shkeljeve të kryera nga kërkuesi. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs kërkuesi.

5. Mbi rekursin e kërkuesit në Gjykatën e Lartë është regjistruar çështja nr. 31001-00511-00-2024, datë 22.10.2024. Në datën 28.04.2025 Kolegji Administrativ i asaj gjykate ka vendosur vijimin e shqyrtimit të rekursit në dhomën e këshillimit, sipas rregullave të parashikuara në nenet 61 e vijues të ligjit nr. 49/2012, datë 03.05.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*).

6. Në datën 17.04.2026 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të nenit 27 të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 04.05.2026.

7. Me vendimin e datës 28.05.2026 Mbledhja e Gjyqtarëve ka rrëzuar kërkesën e kërkuesit të datës 26.05.2026 për përjashtimin e një gjyqtari nga shqyrtimi i çështjes së tij, duke vlerësuar se në kuptim të përmbajtjes së nenit 36, pika 1, të Ligjit Organik të Gjykatës dhe nenit 18, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në analizë të testit objektiv dhe subjektiv, në funksion të paanësisë së gjyqtarit, rrethanat faktike të përshkruara nga kërkuesi nuk krijojnë premisa për vendosjen e gjyqtarit në kushte të një pjesëmarrjeje në gjykim që të mund të konsiderohet si e njëanshme qoftë edhe në dukje.

II

Pretendimet e kërkuesit

8. ***Kërkuesi***, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar:

8.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, në drejtim të:

8.1.1. *Së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm*, pasi pavarësisht se Gjykata e Lartë ka pranuar çështjen për shqyrtim, nuk ka marrë asnjë vendim brenda afatit ligjor dhe prekluziv prej 90 ditësh të parashikuar nga legjislacioni procedural. Mosveprimi i Gjykatës së Lartë ka prodhuar pasoja të drejtpërdrejta dhe të vazhdueshme për kërkuesin, duke mbajtur në fuqi një masë disiplinore të diskutueshme që cenon rëndë të drejtat e tij profesionale dhe pasurore.

- 8.1.2. *Së drejtës së mbrojtjes efektive*, pasi mjetet e brendshme të ankimit nuk kanë qenë reale, efektive dhe të përshtatshme për të ndaluar pasojat e vazhdueshme të cenimit në të drejtat e kërkuarit.
- 8.1.3. *Standardit të dyshimit të arsyeshëm*, pasi mungesa e dokumentit procedural, mungesa e procesverbaleve disiplinore të bordit dhe dyshimet për falsifikim të raportit të kontrollit krijojnë një standard të dyshimit të arsyeshëm mbi ligjshmërinë e procedurës disiplinore. Nga analiza e dokumentacionit rezulton se raporti i kontrollit paraqet mangësi serioze që krijojnë dyshime të arsyeshme mbi integritetin e kërkuarit.
- 8.1.4. *Përdorimit të provës së paligjshme*, pasi raporti i kontrollit mbi të cilin është ngritur procedimi disiplinor rezulton i kompromentuar nga elemente paligjshmërie, përfshirë falsifikimin e nënshkrimit të njërit prej inspektorëve, e provuar kjo përmes ekspertimit grafik dhe objekt hetimi penal.
- 8.1.5. *Parimit të sigurisë juridike*, pasi vendimi i heqjes së licencës është mbështetur në akte të paqarta dhe procedura të parregullta, si dhe nuk është respektuar vendimi unifikues i Gjykatës së Lartë nr. 272, datë 24.05.2012. Procedimi disiplinor është ngritur mbi një raport kontrolli që nuk plotëson kushtet minimale të vlefshmërisë juridike dhe që rezulton i kompromentuar në aspektin procedural dhe material. Në procedurën administrative dhe disiplinore evidentohet një mbivendosje funksionesh ndërmjet organeve të kontrollit dhe organeve vendimmarrëse, duke cenuar objektivitetin e procedurës.
- 8.2. *E drejta e pronës private*, pasi licenca profesionale e noterit përbën një të drejtë pasurore intelektuale të mbrojtur dhe heqja e saj pa bazë ligjore dhe pa garanci procedurale përbën cenim të drejtpërdrejtë të kësaj të drejte.
- 8.3. *Parimi i proporcionalitetit të ndërhyrjes*, pasi masat e marra nuk janë të balancuara në raport me qëllimin e pretenduar të procedurës disiplinore. Në mungesë të një analize të nevojës së ndërhyrjes dhe të marrjes së masave më të lehta disiplinore, heqja e licencës është joproporcionale dhe përbën masën më të rëndë të mundshme. Përdorimi i një prove të pavlefshme, fshehja e dokumentacionit dhe mungesa e kontrollit gjyqësor e bëjnë ndërhyrjen të paligjshme dhe joproporcionale.
- 8.4. *E drejta e ushtrimit të profesionit*, pasi titulli profesional i noterit nuk është atribut administrativ i Ministrisë së Drejtësisë, por një monopol intelektual individual i fituar përmes kualifikimit dhe ushtrimit profesional, që nuk mund t'i hiqet ose kufizohet jashtë kriterëve ligjore dhe kushtetuese. Heqja e licencës me një

procedurë me mangësi serioze procedurale përbën një ndërhyrje të pajustificuar në ushtrimin e profesionit dhe në aktivitetin ekonomik të kërkuarit.

- 8.5. Gjykata duhet të vendosë *pezullimin e efekteve të akteve të kundërshtuara* deri në përfundimin e shqyrtimit të çështjes prej saj, për të shmangur pasojat e pariparueshme ndaj kërkuarit dhe të urdhërojë Bordin Disiplinor të depozitojë procesverbalet origjinale të të gjitha mbledhjeve disiplinore dhe në rast të mospërmbyshjes të vlerësohet negativisht sjellja e palës.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitetin e kërkuarit

9. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shkrimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

10. Kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative ndaj mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuari të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues. Gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes vlerësohet plotësimi i një ose më shumë kriterëve të legjitimitetit, në varësi të elementeve ose veçantive të çështjes konkrete, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë për kërkuarin. Po kështu, mospërmbyshja edhe vetëm e një kriteri, pa ndjekur një radhë të caktuar të analizës së tyre, me pasojë moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, e bën të panevojshëm verifikimin e kriterëve të tjera. Mbi këtë bazë, në vijim, Kolegji do të verifikojë vetëm kriterin e legjitimitetit të *shkrimit të mjeteve juridike* të kërkuarit.

11. Për sa i përket kriterit të *shkrimit të mjeteve juridike efektive*, individë mund t'i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, vetëm pasi të ketë shtruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Ky kriter kërkon shfrytëzimin në rrugë normale të mjeteve juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme,

të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete (*shih vendimet nr. 31, datë 29.05.2023; nr. 15, datë 11.03.2021; nr. 38, datë 25.04.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Mbrojtja kushtetuese ka funksion subsidiar, që do të thotë se ajo mund të kërkohe vetëm për një vendim përfundimtar, të çfarëdolloj forme, që përmbyll procesin gjyqësor, pasi individi ka shteruar mjetet dhe rrugët e tjera ligjore (*shih vendimet nr. 29, datë 16.04.2024; nr. 18, datë 19.03.2024; nr. 38, datë 02.12.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Ky kriter përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuesi, i cili, përpara se t'i drejtohet Gjykatës, duhet të vërtetojë se i ka përdorur të gjitha mjetet ligjore të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Mjetet ligjore shterojnë kur në varësi të rrethanave të çështjes rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimin nr. 10, datë 04.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Qëllimi i kësaj dispozite kushtetuese është, ndër të tjera, të mundësojë, brenda sistemit gjyqësor të zakonshëm, parandalimin ose riparimin e shkeljeve të pretenduara, përpara se të tilla pretendime të paraqiten në Gjykatë (*shih vendimet nr. 14, datë 11.03.2021; nr. 29, datë 30.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Në kuptim të këtyre standardeve, si dhe referuar akteve bashkëlidhur ankimit kushtetuese individual, Kolegji konstaton se kërkuesi i është drejtuar gjykatës administrative me padi me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 4/2021 të Bordit Disiplinor dhe urdhrit nr. 383/2021 të ministrit të Drejtësisë, kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme, si dhe fshirjen e çdo regjistrimi të kryer në regjistrin e noterëve pranë Ministrisë së Drejtësisë në lidhje me këtë vendim. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 2953 (80-2021-2995), datë 26.10.2021, ka vendosur rrëzimin e padisë, vendim i cili është lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr. 296 (86-2024-336), datë 06.03.2024. Mbi rekursin e kërkuesit në Gjykatën e Lartë, në datën 22.10.2024, është regjistruar çështja nr. 31001-00511-00-2024.

14. Në pritje të gjykimit të çështjes së tij në Gjykatën e Lartë, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual me dy kërtime kryesore: i) kundërshtimin e akteve administrative që kanë vendosur heqjen e licencës së ushtrimit të profesionit të noterit dhe të vendimeve gjyqësore që kanë vendosur rrëzimin e padisë, për shkak të shkeljes të të drejtave kushtetuese të kërkuesit; ii) konstatimin e shkeljes të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, për shkak se Gjykata e Lartë nuk ka dhënë vendim brenda afatit ligjor 90-ditor, duke zvarritur gjykimin, çka ka sjellë pasoja të drejtpërdrejta dhe të vazhdueshme në të drejtat e kërkuesit.

15. Për sa i përket kërimit të parë, që ka të bëjë me procesin gjyqësor të vënë në lëvizje nga kërkuuesi për shfuqizimin e akteve administrative për heqjen e licencës së tij, nga të dhënat e faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë rezulton se çështja e kërkuarit, e vënë në lëvizje mbi rekursin e tij, është ende në shqyrtim në atë gjykatë dhe për të nuk ka ende një vendim përfundimtar. Për rrjedhojë, për sa i përket këtij kërkit kërkuuesi ka ende mjete juridike në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij të pretenduara të cenuara, përfshirë më pas edhe mbrojtjen kushtetuese në këtë Gjykatë.

16. Për sa i përket kërimit tjetër, për konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm për shkak të tejkalimit të afatit ligjor 90-ditor nga Gjykata e Lartë, Kolegji vëren se, si rregull, shqyrtimi i këtyre lloj çështjeve dhe vlerësimi përfundimtar në lidhje me kohëzgjatjen e arsyeshme të gjykimit duhet të bëhet nga gjykatat e zakonshme, sipas kompetencës që parashikon KPC-ja, në përputhje me parimin e subsidiaritetit. Gjykata ka pranuar se në parim mjetet e parashikuara nga nenet 399/1 e vijues të KPC-së janë efektive, ndërsa në praktikë efektiviteti i tyre duhet shqyrtuar nën dritën e rrethanave të çdo rasti konkret (*shih vendimet nr. 3, datë 17.02.2022; nr. 2, datë 17.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, individit duhet t'u drejtohet gjykatave të zakonshme në përputhje me parashikimet e KPC-së dhe vetëm pasi të ketë shteruar garancitë e mbrojtjes që i ofrohen nga juridiksioni i zakonshëm gjyqësor, ai mund të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues (*shih vendimet nr. 46, datë 03.10.2023; nr. 44, datë 26.09.2023; nr. 2, datë 17.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Bazuar në këto standarde, si dhe referuar rrethanave të çështjes konkrete, Kolegji vëren se kërkuuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual në datën 17.04.2026, i cili është regjistruar, pas plotësimit të tij, në datën 04.05.2026. Nga informacioni i dërguar nga Gjykata e Lartë, si dhe nga të dhënat e faqes zyrtare të asaj gjykate, rezulton se në datën e paraqitjes së ankimit kushtetues, kërkuuesi nuk kishte paraqitur në Gjykatën e Lartë kërkesë për konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm të gjykimit, në përputhje me parashikimet e neneve 399/6 të KPC-së, për të cilat Gjykata ka pohuar se në parim janë mjete efektive dhe duhet të shterohen përpara paraqitjes së ankimit kushtetues individual. Vetëm pas shterimit të këtyre garancive që i ofrohen brenda juridiksionit të zakonshëm gjyqësor, në mungesë edhe të faktit se kërkuuesi as nuk ka pretenduar dhe as nuk ka provuar mungesën e efektivitetit të një mjeti të tillë, ai mund të vinte në lëvizje gjykimin kushtetues.

18. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se kërkuuesi nuk legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës, pasi nuk ka përmbushur kriterin e shterimit të mjeteve juridike në dispozicion.

19. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual i kërkuarit nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.